



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.15, datë 22/12/2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIE 00011 SERIAL,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 7.05.2021, “LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR”, TË SUBJEKTIT
“TIRANA BUSINESS PARK” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, *“Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”*, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr.00011 serial “Leje për përdorim burimi ujor nëntokësor”, miratuar me Vendim Nr.2 datë 7.05.2021, të subjektit “Tirana Business Park” sh.p.k, me vendndodhje: Bashkia Vorë, Qarku Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit:

X= 475400.2; Y= 4584153.16; Z= 38 m; (KRGJSH)

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime sanitare.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 5.5$ l/sek

Volumi i shkarkimit të ujërave të përdorura: $Q = 1$ l/sek

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Lumi i Tiranës

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit të subjektit.

KRYETARI I KBL ISHËM

EMILJAN JANI

